



# ***REFORMA NË DREJTËSI: ROLI I INSPEKTORATIT TË LARTË TË DREJTËSISË (ILD)***

Dokument Politikash



*Ky publikim i Institutit për Studime Politike (ISP) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, "Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri", zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.*

*Mendimet e shprehura në këtë dokument politikash janë të Institutit për Studimet Politike (ISP) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.*

## **Autor**

**Dr. Erind Merkuri**

Ekspert i lartë

Fakulteti i Drejtësisë (UT)

## **Rishikoi dokumentin:**

Ekspertët e ISP

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botiminuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

## Përmbajtja

I.	HYRJE	7
II.	GJETJE DHE KONKLUSIONE	8
III.	REKOMANDIME	11
IV.	ILD, KRIJIMI DHE BILANCI	13
V.	VLERËSIMI I KUADRIT KUSHTETUES DHE LIGJOR	15
	a. ORGANIZIMI NË NIVEL LIGJOR	17
	b. PËRZGJEDHJA E INSPEKTORIT TË LARTË	17
	c. NGRITJA E ADMINISTRATËS SË ILD-SË	18
VI.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE E ILD-SË	22
VII.	ANKESAT E MBARTURA	22
VIII.	ANKESAT E PARAQITURA PAS KRIJIMIT TË ILD-SË	22
IX.	VITI 2020	23
X.	VITI 2021	26
XI.	VITI 2022	30
	BIBLIOGRAFIA	33

## Lista e shkurtimeve

ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KED	Këshilli i Emërimeve të Drejtësisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
SHM	Shkolla e Magjistraturës

## Hyrje

Reforma në drejtësi filloi me synimin që sistemi i drejtësisë të ndryshonte totalisht, për të krijuar një sistem sa më eficient dhe rikthimin e besimit të publikut tek ky sistem. Për këtë arsye u krijua një sistem rivlerësimi kalimtar që do të kontrollonte të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Shqipërisë, si edhe u ngritën organe të reja për administrimin e sistemit të drejtësisë si, KED, KLGJ, KLP dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Ky i fundit u krijua me një qëllim të qartë, që nëpërmjet kompetencave që ai do të ushtronte ta bënte sistemin e drejtësisë më të përgjegjshëm dhe të pengonte që sistemi i ri të kthehej në formën e mëparshme. Për këtë arsye përgjegjësitë e këtij institucioni janë të mëdha.

Emërimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bëhet nga Kuvendi, në bazë të kandidaturave të sjella nga KED. Pra, në këtë rast pozita dhe prestigji barazohet më atë të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Por KED e viteve 2017 dhe 2018 nuk funksionuan, duke sjellë dhe vonesa në fillimin dhe funksionimin e ILD. Vetëm KED i 2019 arriti të sjellë kandidaturat në Kuvend, i cili në muajin janar 2020 arriti të zgjedhë Inspektorin e parë të Lartë të Drejtësisë.

Këtij funksionari i ngarkohet detyra për ngritjen e këtij institucioni. Është e kuptueshme që një detyrë e tillë nuk ishte e lehtë, e komplikuar kjo edhe më ngjarje të tjera jashtë kontrollit të tij, si pandemia Covid-19. Gradualisht, struktura institucionale filloi të ngrihej, por sfidat për këtë institucion janë të shumta si shqyrtimi i ankesave të mbartura në vite, ashtu edhe trajtimi i ankesave të reja që vinin në këtë institucion. Kësaj i shtohet edhe barra e realizimit të inspektimeve tematike. Këto detyra duhet që të realizohen ndërkohë që nuk kemi një administratë të konsoliduar dhe të plotësuar në të gjitha nivelet e saj.

Qëllimi i këtij raporti është që të japë një pasqyrë të veprimtarisë së këtij institucioni, gjatë tre viteve të para të funksionimit të tij, sfidat me të cilat është përballur, sukseset që ka arritur, problematikat e hasura, si edhe mënyrën e përmbushjes së kompetencave të tij. Në fund raporti përmbillet me pjesën e konkluzioneve dhe të rekomandimeve.

Dokumenti është pjesë e angazhimit të Institutit të Studimeve Politike (ISP) në kuadër të projektit *"Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien në përmbushje të kriterëve të Grupit të Parë të Kapitujve Negociues"*. Projekti mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë dhe po jetësohet nga një grupim organizatash ku bën pjesë ISP, nën drejtimin e Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), në partneritet me Komitetin Shqiptar i Helsinkit dhe Institutin e Shkencës. Objektivi i projektit është të mbështesë negociatat e pranimit të Shqipërisë në BE lidhur me Grupin e Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes përmirësimit të debatit të politikave, forcimit të llogaridhënies dhe rolit të OSHC-ve në proces. Cluster 1 përmban kapitujt e mëposhtëm: (23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, 5 – Prokurimi publik, 18 – Statistikat, 32 – Kontrolli financiar dhe kriteret ekonomike, funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike).

## Gjetje dhe konkluzione

ILD është një institucion i krijuar për herë të parë në Shqipëri, me amendimet kushtetuese të miratuara nga Kuvendi me ligjin nr.76/2016. Organizimi i tij më tej u detajua në Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

- Nga analiza e kompetencave që ILD -ja ka, procedurat që ndjek dhe të praktikës konkrete të realizuar prej tij, tregon që jemi përpara një institucioni mjaft të fuqishëm, i cili mund të procedojë të gjithë sistemin e drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë, anëtarët e këshillave, si edhe Prokurorin e Përgjithshëm. Përfundimisht mbetet vetëm Gjykata Kushtetuese. Pra, është një pushtet i jashtëzakonshëm, i përqendruar në duart e një njeriu të vetëm, që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Për këtë arsye, puna e këtij institucioni duhet që të monitorohet vazhdimisht nga aktorë të ndryshëm, me qëllim mbajtjen e tij të përgjegjshëm përballë funksioneve që mbart. Gjithashtu, duke qenë se është një institucion i ri, sfida e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë aktual është mjaft e rëndësishme që të krijojë mekanizma të brendshëm që puna e institucionit të jetë e dokumentuar në të gjitha hallkat, me qëllim monitorimin e saj në mënyrë të vazhdueshme.
- Si një institucion i ri, pati dy probleme: e para mungesa e burimeve njerëzore dhe infrastrukurore dhe e dyta trashëgoi një ngarkesë të madhe ankesash të paraqitura nga ana e subjekteve të ndryshme. Një tjetër problematikë, megjithëse anësore, por që ndikoi në fillimin e punës së ILD-së dhe ngritjes si institucion ishte fillimi i pandemisë COVID-19 dhe masat e marra nga autoritet shqiptare për luftimin e saj. Kjo solli një pengesë disa mujore, që ndikoi në përpjekjet për ngritjen e institucionit. Një tjetër problematikë që shoqëroi ngritjen e institucionit ishte edhe vijimi i paraqitjes së ankesave ndaj magistratëve nga subjekte të ndryshme.
- Këto katër aspekte të marra së bashku prodhuan një gjendje sfiduese për ILD. Megjithatë përpjekjet për krijimin e këtij institucioni vijuan në fillim me ngritjen fillimisht të strukturës së përkohshme dhe më pas me miratimin e strukturës së përhershme nga ana e Kuvendit. Struktura aktuale e ILD përfshin në total një administratë të përbërë nga 93 punonjës. Bërthama e kësaj strukture duhet që të jetë grupi i inspektorëve që duhet të përbëhet nga 26 inspektorë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis magistratëve dhe jomagjistratëve.
- Plotësimi i këtyre vendeve ka paraqitur një sfidë më vetë. Kështu ILD, trashëgoi nga ish-KLD vetëm një inspektor magistrat, i cili nga ana e tij kishte aplikuar për ngritje në detyrë, duke e vënë në diskutim kohën e qëndrimit të tij në ILD. Megjithëse nga ana e KLGJ-së, u shpall dhe u rishpall procedura për komandimin e magistratëve në ILD, të paktën 7 herë, nuk pati asnjë interes nga ana e magistratëve, profili gjyqtar. Kjo mund të shpjegohet me disa

arsye, ku e para mund të jetë kalimi në procedurën e rivlerësimit kalimtar me përparësi në rast komandimi në ILD. Gjithashtu krijimi i pozicioneve të lira në gjyqësor gjatë kësaj periudhe, si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, ka sjellë që interesi i magistratëve të drejtohet drejt pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë si edhe në gjykatat e apeleve. Kjo prirje është e kuptueshme dhe lidhet edhe me kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për inspektor, kriteret këto të cilat janë shumë të larta dhe që praktikisht një person që i plotëson është një kandidaturë potenciale edhe për këto gjykata. Nga ana e tij KLP, ka komanduar në fillim 4 magistratë, profili prokuror, por njëri prej tyre u largua si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar.

- Sa i përket inspektorëve jomagjistratë, nga ana e ILD janë kryer disa procedura dhe është arritur që të plotësohet pjesa e tyre. Megjithatë me qëllim që edhe kjo kategori inspektorësh të jetë me integritet të lartë, ligji kërkon realizimin e disa procedurave vlerësimi, të cilat kërkojnë kohën e tyre.
- Në lidhje me shqyrtimin e ankesave të paraqitura, ILD ka tentuar që të ruajë një balancë midis ankesave të mbartura përpara krijimit të institucionit dhe ankesave të reja të paraqitura. Qasja e ILD duket e saktë, me qëllim që ankesat e reja të mos prisnin radhën e shqyrtimit duke dëmtuar në këtë mënyrë pritshmërinë që subjektet e ndryshme kishin në institucionin e ri.
- Sa i përket ankesave të mbartura, nga ILD u krijua një grup pune fillimisht për qartësimin e tyre duke qenë se ato ndodheshin në faza të ndryshme shqyrtimi. Mbi këtë bazë u bë dhe një ndarje e mënyrës së shqyrtimit të tyre bazuar në disa prioritete. Me vonë me rritjen e numrit të inspektorëve u krijua dhe një grup i posaçëm vetëm për shqyrtimin e tyre. Pavarësisht kësaj shqyrtimi i tyre ka ecur me ritme jo shumë të shpejta duke qenë se edhe në vitin 2023 ka ende çështje të mbartura nga kjo kategori. Tejzgjatja në kohë e këtyre ankesave, përveçse ul besimin e publikut, gjithashtu mund të sjellë si pasojë kalimin e afateve të parashkrimit, duke shmangur përgjegjësinë e subjekteve. Theksojmë megjithatë që kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kombinimit të disa faktorëve, të trajtuara më sipër, që ishin dhe jashtë kontrollit të ILD-së. Në lidhje me ankesat e paraqitura, mbas krijimit të ILD, procesi i ndjekjes së tyre ka qenë më i kënaqshëm, ku në pjesën më të madhe janë shqyrtuar dhe kanë marrë zgjidhje brenda afateve të kënaqshme.
- Është e kuptueshme që puna e një institucioni nuk matet vetëm në terma sasiorë, por edhe cilësorë. Nga të dhënat e disponueshme rezulton që për vendimet e arkivimit, ankimmimet kanë qenë shumë të pakta dhe në çdo rast këto vendime janë lënë në fuqi nga këshillat respektive. Numri i pakët i vendimeve të ankimuarat tregon që subjektet janë bindur nga arsyetimi i ILD-së, fakt ky që tregon besim në institucion. Ndërsa fakti që asnjë prej këshillave nuk ka kthyer prej vendimeve të arkivimit tregon që puna e ILD ka qenë profesionale.
- Në lidhje me kërkesat për procedim të nisura nga ILD-ja rezulton se deri më tani ato janë pranuar të gjitha, me përjashtim të një kërkesë që është rrëzuar nga KLP-ja. I vetmi dallim që ekziston është që këshillat jo gjithmonë kanë pranuar masën e propozuar nga ILD-ja, pasi nuk u është dukur proporcionale duke vendosur një masë më të ulët se sa ajo e

kërkuar. Pavarësisht kësaj, dallimet midis masave të propozuara nga ILD dhe të marra nga këshillat nuk kanë dallime të forta, si edhe mbi të gjitha e rëndësishme për ILD-në është fakti që këshillat kanë pranuar që ka shkelje disiplinore nga magjistrati. Vendimet që kanë marrë këshillat, mbi bazën e kërkesës së ILD-së dhe që më vonë janë ankimuar në KPA, janë konfirmuar prej kësaj të fundit. Këto të dhëna tregojnë për një rezultat pozitiv edhe për punën e ILD-së për sa i përket procedimit të magjistratëve. Kjo tregon që puna e ILD-së ka qenë profesionale dhe e bazuar, përderisa nga ana e këshillave, në shumicën e rasteve janë marrë në konsideratë.

- Aspekti tjetër, që mbetet për t'u diskutuar janë inspektimet tematike. Në realizimin e këtyre inspektimeve, ILD ka qenë e kufizuar, siç është trajtuar më sipër, për shkak të mangësive në personel dhe numrit të lartë të ankesave të mbartura dhe të paraqitura. Megjithatë nga ana e ILD-së janë realizuar tre inspektime tematike. Ajo që duket interesante është se ILD-ja, për shkak të problematikave që kanë dalë, ka proceduar që në fillim me procedimin e disa magjistratëve, pa pritur përfundimin e inspektimit.
- Nga sa më sipër, rezulton se ILD-ja, pavarësisht vështirësive të shfaqura, ka treguar një përkushtim në ngritjen e një institucioni, i cili është një nga themelet e reformës së drejtësisë, të nisur nga Kuvendi që në vitin 2016. Megjithëse është e kuptueshme që puna e ILD-së ka vend për përmirësime, duket se institucioni ndodhet në rrugë të mbarë.



## Rekomandime

Me qëllim përmirësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rekomandojmë që:

- Ndryshimi i raportit që parashikon ligji midis trupës së inspektorëve. Duke qenë se trupa e inspektorëve është bërthama e funksionimit të këtij institucioni dhe kjo trupë nuk është plotësuar plotësisht atëherë është e nevojshme që raporti midis inspektorëve magjistratë dhe jomagjistratë të ndryshojë.
- Në këtë drejtim rekomandojmë që të mos ketë një raport të mirëfilltë midis këtyre dy prurjeve, por në rast se për të njëjtin vend kandidojnë si nga trupa e magjistratëve, ashtu edhe e jo magjistratëve, atëherë, kandidati magjistratë të ketë një vlerësim shtesë për shkak të profilit të tij. Në këtë drejtim mundësohet ILD të plotësojë trupën e inspektorëve.
- Gjithashtu për të rritur mundësinë e aplikimit të kandidatëve magjistratë, rekomandohet ulja e kriterëve të parashikuara nga ligji. Kjo pasi me kriterë kaq të larta, ata magjistratë që i plotësojnë do të paraqesin interes që të që të aplikojnë për ngritje në detyrë dhe jo inspektor pranë KLGJ-së.
- Duke qenë se inspektorët, pavarësisht se janë magjistratë apo jo magjistratë, kryejnë të njëjtën punë dhe potencialisht kanë të njëjtën ngarkesë, diferenca në pagë që parashikon legjislacioni në fuqi duhet që të ndryshohet duke u barazuar të dyja këto kategori në trajtimin financiar. Në këtë aspekt dhe nuk ka diskriminim midis vetë inspektorëve dhe krijon një frymë më të mirë bashkëpunimi.
- ILD-ja nuk duhet të ketë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të këshillave që nuk pranojnë masat disiplinore të kërkuara prej tij. Kjo rrjedh nga Kushtetuta e cila parashikon që propozimet e ILD-së shqyrtohen nga ana e këshillave dhe nuk parashikon rrugë ankimore kundër vendimmarrjes së tyre. Pra, nuk parashikohet në asnjë pjesë të Kushtetutës, mundësia e gjykatave për të marrë masa disiplinore ndaj magjistratëve. Ndërkohë që magjistrati i penalizuar mund të ankohet pasi cenohet statusi i tij i punës dhe të drejtat që rrjedhin prej saj. ILD nuk ka shkak që të ankimojë më tej vendimmarrjen e këshillave.

- Për të ruajtur të drejtat procedurale të ILD-së, rekomandohet vetëm mundësia e ankimit të vendimeve të këshillave për shkaqe të rënda procedurale, por jo për themelin e vendimmarrjes.
- Për të trajtuar fondin e ankesave të mbartura rekomandohet një mundësi zgjidhjeje si rasti i Gjykatës së Lartë, ku të merren ndihmës të jashtëm, për të ndihmuar strukturat përkatëse me inventarizimin e ankesave dhe krijimin e inventarit të dosjeve.
- Një problem ligjor mbetet situata kur nga ankesat e paraqitura, ose inspektimet tematike, dalin shkelje disiplinore për anëtarët e KLP-së dhe të KLGJ-së. Në këtë rast mund të diskutohet, nëse këta do të hetohen dhe procedohen administrativisht si magjistratë, apo si anëtarë të këshillave. Kjo situatë do një zgjidhje ligjore ku rekomandohet që të trajtohen si anëtarë të këshillave përderisa kanë atë mandat në momentin e procedimit disiplinor.

## ILD, krijimi dhe bilanci

Në Kushtetutën e Shqipërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë citohet 6 herë në nenet 135, 147/d, 147/dh, 147/e, 147/ë, 149/d dhe 179. Bazuar në këto dispozita rezulton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbulon shqyrtimin e ankesave, hetimin dhe fillimin e procedimit disiplinor për të gjithë magjistratët, për Prokurorin e Përgjithshëm, si edhe anëtarët e KLP-së dhe të KLGJ-së.

Shkaqet e pezullimit dhe të shkarkimit të këtyre subjekteve janë të njëjta për të gjithë. ILD-ja në këtë rast vihen në lëvizje nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, anëtarët e këshillave, kryetarët e gjykatave ose drejtuesit e prokurorive, por edhe nga individët (personat fizikë dhe juridikë).

Nga momenti i depozitimit të ankesës nga subjektet e sipërcituara te Inspektori i Lartë i Drejtësisë bëhet shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës duke kaluar më pas në verifikimin e ankesës (në përfundim të këtyre procedurave ILD mund të vendosë dhe arkivimin e ankesës), hetimin disiplinor dhe procedimin disiplinor.

Në nivel ligjor organizimi dhe funksioni i këtij institucioni rregullohet nga Ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", i ndryshuar, në Pjesën IV, Krerët I-IV, nenet 193-216. si edhe ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar, Pjesa V, Krerët I-III, nenet 100-157, që rregullon mënyrën e procedimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është emëruar me vendimin nr. 2 datë 20.1.2020 të Kuvendit të Shqipërisë. Nga ana institucionale ILD me urdhrin nr.1, datë 07.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së përkohshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratoi fillimisht *strukturën e përkohshme* të institucionit me 40 punonjës. Më pas me vendimin nr.28/2020 të Kuvendit u miratua struktura e përhershme e këtij institucioni, që duhet të ketë 93 punonjës. Gjatë vitit 2020 u punësuan 53 punonjës ndërkohë që pati probleme me rekrutimin e inspektorëve magjistratë. Për këtë kategori ILD realizoi disa procedura rekrutimi, të cilat kërkonin dhe kohën e tyre për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve.

Gjatë vitit 2020, ILD ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë vetëm me një inspektor magjistrat të komanduar nga KLGJ. Më tej në muajin shkurt 2021, janë komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, katër magjistratë të profilit prokurorë. Për një inspektor magjistrat, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, në muajin Korrik 2021, për shkak të vendimmarrjes së KPK, për shkarkimin nga detyra, vendim që është ankimuar pranë KPA.

Për sa i përket veprimtarisë së ILD-së kjo e fundit trashëgoi 2.104 ankesa të regjistruara përpara datës 1 shkurt 2020, dita kur filloi zyrtarisht funksionimin Inspektori i Lartë i Drejtësisë si institucion kushtetues. Shqyrtimi i këtyre ankesave filloi në vitin 2020 dhe vijoi në vitin 2021 ku u shqyrtuan 427 ankesa.<sup>1</sup> Në vitin 2022, nga ILD u shqyrtuan nga ky fond 534 ankesa të tjera, duke mbetur ende një fond prej 1072 ankesash.

Për sa i përket ankesave të reja të ardhura mbas datës 1 shkurt 2020, ato janë 950 ankesa për vitin 2020, ndërkohë që janë miratuar në total 184 vendime që kanë trajtuar 173 ankesa. Nga viti 2020 në vitin 2021 u mbartën 2.870 praktika. Për sa i përket procedimeve disiplinore, rezulton se ILD ka miratuar 8 vendime për fillimin e hetimit disiplinor përkatësisht për 2 (dy) prokurorë dhe 6 (gjashtë) gjyqtarë. Janë formuluar edhe 4 (katër) kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, 3 (tre) pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të pranuar të gjitha ndërsa një e paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë u rrëzua.

- Për vitin 2021 janë depozituar 1257 ankesa të reja, nga ku ILD ka shqyrtuar 1719 ankesa, ku 1433 ankesa janë arkivuar, 270 ankesa u mbartën për vitin 2022, u morën **22** vendime për fillim hetimi disiplinor dhe iu paraqitën **17** kërkesa këshillave.
- Për vitin 2022 janë depozituar 789 ankesa të reja, ku nga ana e ILD janë shqyrtuar në total 1715 ankesa (bashkë me ato të mbartura) të konkluduara me 1234 vendime: nga të cilat **862** vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, **344** vendime për arkivimin pas verifikimit dhe **28** vendime për hetim disiplinor.

Për sa i përket inspektimet tematike ILD ka nisur një inspektim tematik në vitin 2020 dhe dy inspektime të tjera në vitin 2021 dhe konkretisht :

- *Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, "Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirimin me Kusht".*
- *Vendim nr. 37, datë 01.06.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: "Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i ndryshuar.*
- *Vendim nr. 47, datë 15.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: "Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal" për veprën penale "Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit".*

Bazuar në të dhënat e mbledhura për inspektimin tematik për "lirimin me kusht", janë paraqitur 2 kërkesa për procedim disiplinor në vitin 2020, 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2022. Por ky inspektim ende nuk është konkluduar me një raport final, ndërsa për dy inspektimet e tjera tematike, ILD ka dalë me një raport final, ku janë konstatuar problematikat dhe janë pasqyruar rekomandimet përkatëse.

<sup>1</sup> Raporti ILD-së për vitin 2021, fq.12.

## Vlerësimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor i ILD-së

Në Kushtetutën e Shqipërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë citohet 6 herë në nenet 135, 147/d, 147/dh, 147/e, 147/ë, 149/d dhe 179. Nga këto dispozita rezulton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbulon shqyrtimin e ankesave, hetimin dhe fillimin e procedimit disiplinor për:

- a) gjyqtarët
- b) prokurorët
- c) Prokurorin e Përgjithshëm
- ç) anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor
- d) anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Referuar neneve 140, 147/c, 148/d si edhe 149/c të Kushtetutës, nuk rezulton që të ketë ndryshime në shkaqet e pezullimit të këtyre funksionarëve nga detyra, ose në shkaqet e shkarkimit të tyre. Kështu si shkaqe pezullimi rezulton të jenë rastet kur ndaj këtyre subjekteve:

- *a) caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një veprë penale;*
- *b) marrin cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;*
- *c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit (nenet 140, pika 2, 147/c, pika 2, 148/d, pika 2 si edhe 149/c, pika 2 të Kushtetutës).*

Si shkaqe shkarkimi për këto subjekte normat kushtetuese janë identike kur përmendin vetëm

a) kryerjen e shkeljeve të rënda profesionale ose etike; ose b) dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi (nenet 140, pika 1, 147/c, pika 1, 148/d, pika 1 si edhe 149/c, pika 1 të Kushtetutës).

Pika 2 e nenit 194 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, përcakton si më poshtë se ILD-ja vihet në lëvizje me:

- a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar;*
- b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;*
- c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm;*
- ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;*
- d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore;*
- dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.*

Nga momenti i depozitimit të ankesës nga subjektet e sipërcituara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndjek fazat e mëposhtme:

**- Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës**

ILD shqyrton fillimisht nëse ankesa "*prima facie*" përmbush disa kritere pranueshmërie. Nëse njëri prej ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk plotësohen, atëherë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nxjerr vendimin për arkivimin e ankesës.

**- Verifikimi i ankesës**

Në raste ku *prima facie* ankesa ka të dhëna që kanë nevojë për verifikim vendoset verifikimi i saj. ILD në këtë rast mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar, si dhe mund të marrë çdo informacion tjetër nga Këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Pas administrimit të dokumentacionit, në kuadër të verifikimit të shkeljes së pretenduar, në rast se konstatohet se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet dhe vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

**- Hetimi disiplinor**

Hetimi disiplinor mund të nisë në dy mënyra. E para, nëse, pas verifikimit, ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura gjatë verifikimit, që justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit apo magjistratëve ndaj të cilëve ngrihen pretendimet nga ankuesi, ILD fillon hetimin.

Në rastin e dytë hetimi disiplinor mund të fillohet edhe nëse pas shqyrtimit fillestar krijohen dyshime të arsyeshme se shkelja disiplinore mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë dhe fillimin e hetimit. Pra një vendim hetimi disiplinor mund të merret nga ILD edhe pa kaluar fazën e verifikimit, nëse janë kushtet ligjore të sipërpërmendura.

Hetimi disiplinor është një ndër tre fazat e shqyrtimit të ankesës i cili nis:

*- Me nismë të ankuesit, nëse konstatohet apo ka dyshime se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë dhe fillimin e hetimit. Gjatë hetimit disiplinor bëhet një hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me dyshimet e ngritura gjatë fazës së shqyrtimit fillestar apo verifikimit të ankesës.*

*- Me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në të dhëna thelbësore mbi faktet që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.*

Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor mund të merret pas shqyrtimit fillestar apo verifikimit të ankesës, nëse konstatohet apo ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë dhe fillimin e hetimit.

Në rast se pas kryerjes së hetimit dhe përfundimit të procedurave përkatëse, ILD vlerëson se nuk provohet shkelja apo pretendimet janë të pabazuara në ligj dhe në provat e mbledhura, vendos mbylljen e hetimit disiplinor. Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, atëherë ILD fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore pranë Këshillit përkatës (KLGJ ose KLP).

### - Procedimi disiplinor

Pas paraqitjes së raportit të hetimit nga ILD pranë Këshillit përkatës, ky i fundit cakton datën e seancës dhe njofton palët brenda afateve të përcaktuar në ligj.

Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:

- a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
- b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.<sup>2</sup>

## Organizimi në nivel ligjor

Ligj nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", i ndryshuar, në Pjesën IV, Krerët I-IV, nenet 193-216, rregullon në mënyrë të detajuar normat kushtetuese që kanë të bëjnë me objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pavarësinë, buxhetin dhe strukturën e institucionit, statusin e inspektorit të Lartë të Drejtësisë, papajtueshmëritë, përzgjedhja, mandati, kompetencat, Zëvendësinspektorin e Lartë të Drejtësisë, hetimin e shkeljeve disiplinore, mënyrën e emërimit, shkeljet disiplinore dhe statusin e inspektorëve.

Ndërkohë që ligji i mësipërm rregullon çështjet organizative, është ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar, Pjesa V, Krerët I-III, nenet 100-157, që rregullon mënyrën e procedimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

## Përzgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr.3 datë 1.3.2019, hapi procedurën e aplikimit në pozicionin për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Gjatë procedurës së vlerësimit të kandidatëve, në fazën përpara verifikimit sipas të dhënave të publikuara hoqën dorë dy kandidatë, në kërkesat e të cilëve nuk parashikohen arsye specifike të dorëheqjes.<sup>3</sup>

Gjatë fazave të mëvonshme, kanë hequr dorë katër kandidatë nga aplikimi:

<sup>2</sup> Raporti ILD, viti 2020, fq.30-32.

<sup>3</sup> Kërkesë datë 14.1.2019 dhe 25.3.2019

Marrë nga faqja e internetit:

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kandidate te terhequr perpara procedures se verifikimit 5916 1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kandidate%20te%20terhequr%20perpara%20procedures%20se%20verifikimit%205916%201.php)

- Një subjekt në aktin e tij të dorëheqjes ka pretenduar se KED kryen procedurën e verifikimit të kandidatëve në mënyrë selektive dhe barazon subjektet që i nënshtrohen deklarimit të pasurive me subjektet private, në rastin konkret ushtrimi i profesionit të avokatit<sup>4</sup>;
- Njëri nga subjektet e tjerë ka shprehur në aktin e tij të dorëheqjes arsyen e mungesës së kohës për plotësimin e dokumenteve të deklarimit të pasurisë<sup>5</sup>;
- Dy kandidatët e tjerë nuk japin arsye specifike në lidhje me dorëheqjen e tyre<sup>6</sup>.
- Në momentin e hartimit të këtij raporti, sipas të dhënave të publikuara nga ky institucion katër kandidatëve i është ndaluar kandidimi për vendin vakant në ILD,<sup>7</sup> referuar vendimeve të publikuara, njëri nga kandidatët ka bërë deklarim të pasaktë të pasurisë<sup>8</sup> dhe tre kandidatët e tjerë nuk plotësonin kriterin e vjetërsisë së punës.<sup>9</sup>

Me vendimin nr. 2 datë 20.1.2020 Kuvendi i Shqipërisë me 98 vota votoi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.<sup>10</sup> Ky votim vinte pas listës së renditur nga KED-ja, nëpërmjet vendimit të datës 23.12.2019, ku kandidati i zgjedhur renditej i pari, me 89.6 pikë.

Pavarësisht ecurisë së procesit, theksojmë se emërimi i Inspektorit të Lartë, nuk passjell menjëherë fillimin e aktivitetit të tij. Kështu për këtë institucion, mungonte totalisht, struktura organizative, infrastruktura e nevojshme, inspektorët që do të ushtrorjnë detyrat përkatëse, personeli mbështetës etj.

## **Ngritja e administratës së ILD-së**

Një nga sfidat e para të krijimit të ILD-së si institucion ishte ngritja e aparatit administrativ të saj. ILD është një institucion i krijuar rishtazi dhe për rrjedhojë nuk trashëgoi burimet financiare, materiale dhe njerëzore të asnjë institucioni tjetër.

Me urdhrin nr.1, datë 07.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së përkohshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratoi fillimisht strukturën e përkohshme të institucionit me 40 punonjës. Bazuar në këtë strukturë, u hartuan përshkrimet e pozicioneve të

<sup>4</sup>Mbi vazhdimësinë e procesit të kandidimit për ILD, datë 8 Maj 2019

Marrë nga faqja e internetit: [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_genci\\_ismaili\\_2058.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_genci_ismaili_2058.pdf)

<sup>5</sup>Marrë nga faqja e internetit: [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_suzana\\_frasheri\\_2046.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_suzana_frasheri_2046.pdf)

<sup>6</sup>Marrë nga faqja e internetit: [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_lefteri\\_lleshi\\_luzi\\_2041.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_lefteri_lleshi_luzi_2041.pdf)  
[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_elira\\_kokona\\_2113.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_elira_kokona_2113.pdf)

<sup>7</sup> Marrë nga faqja e internetit:

<http://www.gjykataelarte.gov.al/web/LISTA EKANDIDAT VE T NDALUAR NGA KANDIDIMET P R VENDIN VAKANT P R INSPEKTOR T LART T DREJT SIS 6064 1.php>

<sup>8</sup>Vendim nr. 53 datë 24.7.2019 i KED

<sup>9</sup>Vendim nr. 77 datë 24.7.2019, vendim nr. 107, datë 2.8.2019, vendim nr. 101 datë 30.7.2019 të KED

<sup>10</sup>Marrë nga faqja e internetit:

<http://parlament.al/Files/Akte/20200124111759vendim%20nr%20%202%20dt%20%2020%201%202020.pdf>

f



punës dhe më datë 08.02.2020 u shpallën 27 pozicione vakante. Pavarësisht kësaj, për shkak të shpalljes së gjendjes së pandemisë në atë kohë, pjesa më e madhe e procedurave u pezullua dhe u arritën të plotësoheshin vetëm 8 vende.

Duke qenë se me datë 18.6.2020, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, vendimi nr. 28/2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", procedurat e mëparshme, të shpallura në bazë të strukturës së përkohshme u anuluan dhe u shpallën procedurat e reja të rekrutimit bazuar në strukturën e re. Këto procedura janë shpallur më datë 25 qershor 2020 dhe kanë vijuar me raundin e dytë të shpalljeve në shtator 2020.

Vendimi nr.28/2020 i Kuvendit, parashikonte një strukturë totale me 93 punonjës. Deri më datë 31 dhjetor 2020, rezultonin të punësuar pranë Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë 53 persona të angazhuar si më poshtë:

Kabineti i Inspektorit:	6 Këshilltarë; 1 Ndhimëse; 1 Sekretare;
Inspektorë magjistratë:	1 Inspektor magjistrat;
Niveli i lartë drejtues:	1 Drejtor i Përgjithshëm;
Niveli i mesëm drejtues:	2 Drejtorë drejtorie ( <i>1 lëvizje paralele dhe 1 ngritje në detyrë</i> ); 14 Ndhimës Inspektorë ( <i>3 lëvizje paralele dhe 11 ngritje në detyrë</i> );
Niveli i ulët drejtues:	5 Përgjegjës sektori ( <i>1 lëvizje paralele dhe 4 me ngritje në detyrë</i> );
Niveli ekzekutiv:	16 Specialistë ( <i>5 lëvizje paralele dhe 11 pranim në shërbimin civil</i> );
Punonjës mbështetës:	6 punonjës me Kod Pune;

Nga sa më sipër, rezulton se në total u realizuan 53 punësime, ku bashkë me Inspektorin e Lartë bëhen 54 punonjës në total. Kjo tregon një diferencë prej 39 punonjësish. Referuar të dhënave diferencat janë në këto sektorë:

Kabineti i Inspektorit:	-1 këshilltar (nga 9)
Inspektorë magjistratë:	-12 Inspektorë magjistratë (nga 13);
Inspektorë jomagjistratë:	-13 Inspektorë jomagjistratë (nga 13);
Niveli i lartë drejtues:	
Niveli i mesëm drejtues:	-1 Drejtor drejtorie (nga 3) -3 Ndhimës Inspektorë (nga 17)
Niveli i ulët drejtues:	-4 Përgjegjës sektori (nga 9)
Niveli ekzekutiv:	-5 Specialistë, <sup>11</sup>

<sup>11</sup> Raporti i ILD-së, për vitin 2020, fq.28.

Nga krahasimi i këtyre të dhënave rezulton se gjatë vitit 2020 nuk u plotësua struktura e ILD, kryesisht me inspektorë, e cila pati ndikim dhe në punën e përgjithshme të ILD për vitin 2020. Theksojmë se kjo është struktura më rëndësishme e këtij institucioni.

Bazuar në nenin 209 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", jo më pak se gjysma e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Pjesa tjetër e inspektorëve emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Nga ana e ILD rezulton që të jenë hapur për konkurrim pozicionet për inspektor jomagjistratë për 6 vende, por në kuadër të këtyre procedurave për shkak të dorëheqjes së disa kandidateve nga kandidimi për inspektor jo magjistratë, janë miratuar 9 (nëntë) vendime me objekt: "Për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit, dhe renditjes së kandidaturës. Për shkak të dorëheqjes nga kandidimi për inspektor jo magjistratë"; Po ashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar dhe 10 (dhjetë) vendime lidhur me ndalimin e kandidimit në vendet vakante për inspektor jo magjistrat si dhe 11 (njëmbëdhjetë) vendime lidhur me lejimin e kandidimit në vendet vakante për inspektorë jomagjistratë.

Në datë 30.09.2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shpallur procedurën për 9 (nëntë) pozicione vakante për inspektorë jomagjistratë, për të cilin aplikuan 19 kandidatë. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimeve të Inspektorëve, i ngritur me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 të ILD-së ka vijuar me dërgimin e shkresave zyrtare pranë institucioneve përkatëse, me qëllim marrjen e informacionit, mbi të cilin do të bazohej verifikimi i plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, si edhe verifikimi i figurës e i pasurisë.

Nga ana e KLGJ-së me vendimin nr. 69, datë 07.02.2020, është komandur përkohësisht një inspektor magjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. KLGJ në mbledhjen e datës 26.02.2020, ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione inspektor magjistrat, por nuk pati asnjë kandidaturë. Për këtë shkak në datë 05.10.2020 dhe më pas në datë 10.07.2020 nga KLGJ është rihapur procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin inspektor magjistrat, por deri në 31 dhjetor 2020 nuk kishte asnjë kandidaturë.

Kjo situatë vijoi edhe për vitin 2021 ku KLGJ në total ka realizuar 7 njoftime, për komandimin e magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit magjistrat pranë Zyrës së ILD-së, të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme në drejtim të plotësimin të nevojave të ILD-së. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në shtator të vitit 2021, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar, rishpalljen e procedurave për kandidimin e 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarë për pozicionin inspektorë magjistratë pranë ILD-së.<sup>12</sup>

Nga KLP-ja me vendimin nr. 37, datë 05.02.2020, u shpall fillimin e procedurës për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit, dhe me vendimin nr. 77, datë 04.03.2020, u komandua një prokuror. KLP më pas

<sup>12</sup> Raport 2021, fq.41.

pranoi 6 kandidatura nga prokurorë për pozicionin inspektor magjistrat dhe vijoi me procesin e vlerësimit të kandidaturave të paraqitura, duke mos i përfunduar brenda vitit 2020.

Në fillim të vitit 2021 KLP mori vendim për komandimin e 4 magjistratëve, profili prokuror si inspektorë magjistratë pranë ILD-së.<sup>13</sup> Por për një inspektor magjistrat, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, për shkak të vendimit të shkarkimit nr. 426, datë 27.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK). Aktualisht rasti është në procedurë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA). Një inspektor tjetër magjistrat, ka përfunduar procesin e rivlerësimit dhe është konfirmuar në detyrë dhe dy magjistratët e tjerë, nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit kalimtar. Vetëm këto tre të fundit rezultojnë që t'i jenë bashkuar ILD-së.<sup>14</sup>

Në mars 2021, rezultojnë që të jenë 8 inspektorë në total.<sup>15</sup> 4 janë jo magjistratë<sup>16</sup> procedurë e mbyllur në shkurt 2021,<sup>17</sup> në shtator 2021 është shpallur procedura për 9 pozicione për inspektorë jomagjistratë.<sup>18</sup>

Për sa i përket administratës së ILD-së, gjatë vitit 2021, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kodit të Punës dhe ligjit organik, u realizuan në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) emërim/rekrutime, si më poshtë:<sup>19</sup>

- |                           |   |
|---------------------------|---|
| • Kabineti                | 3 (tre) emërim Këshilltarë (1 Këshilltar është larguar në muajin shtator 2021 me dorëheqje)               |
| • Niveli i Lartë Drejtues | 1 (një) Sekretar i Përgjithshëm   |
| • Niveli i Mesëm Drejtues | 3 (tre) Ndhmës Inspektorë (2 lëvizje paralele dhe 1 pranë nga jashtë shërbimit civil); (1 pezullim)       |
| • Niveli i Ulët Drejtues  | 1 (një) Përgjegjës, Sektori i Auditimit të Brendshëm (lëvizje paralele);                                  |
| • Niveli Ekzekutiv        | 5 (pesë) Specialistë (1 lëvizje paralele, 4 pranë në shërbim civil); (Liruar me dorëheqje 3 & 1 pezullim) |
| • Punonjës me Kod Pune    | 3 (tre) Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme  |

Totali i emërimeve për vitin 2021 brenda strukturës së miratuar është 24 punonjës/nëpunës. Numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2021 është 93 punonjës të miratuar. Totali është 72 punonjës që ushtrojnë efektivisht detyrën, nga të cilët 64 punonjës brenda strukturës së miratuar dhe 8 punonjës me kontrata të përkohshme. Pra dhe nga ana e ILD-së mbetet nën organike me 21 veta, kryesisht mungesa e inspektorëve.

<sup>13</sup> Vendimet nr. 18, datë 27.01.2021, nr. 19, datë 27.01.2021, nr. 20, datë 27.01.2021 dhe nr. 21, datë 27.01.2021 të KLP-së.

<sup>14</sup> Buletini nr.12, janar 2022, fq.3

<sup>15</sup> Buletini nr.14, mars 2022, fq.6

<sup>16</sup> Buletini nr.16, maj 2022, fq.13.

<sup>17</sup> Buletini nr.18, korrik 2022, fq.3.

<sup>18</sup> Buletini nr.18, korrik 2022, fq.7

<sup>19</sup> Raporti ILD-së për vitin 2021, fq.43

## Veprimtaria profesionale e ILD-së

Veprimtaria e ILD-së u shtri në tre drejtime: e para ka të bëjë më adresimin e ankesave të mbartura, që ishin bërë përpara krijimit të ILD-së, e dyta për trajtimin e ankesave të bëra mbas krijimit të ILD-së dhe e fundit, realizimi i inspektimeve tematike.

### Ankesat e mbartura

Gjendja e ankesave të mbartura si rezultat i periudhës tranzitore mbas hyrjes në fuqi të amendimeve kushtetuese miratuar me ligjin nr.76/2016 deri në fillimin e funksionimit të organeve të reja të sistemit të drejtësisë ishte 2.104 ankesa të regjistruara përpara datës 1 shkurt 2020, si dita kur filloi zyrtarisht funksionimin Inspektori i Lartë i Drejtësisë si institucion kushtetues.

Këto ankesa u transferuan më dy faza në muajt qershor (757 ankesa) dhe korrik (1347 ankesa). Në vitin 2020 nga ana e ILD u ngrit një grup pune për verifikimin e tyre, duke përcaktuar edhe trajtimin e tyre sipas një radhe përparësie bazuar në kriteret si: data e dorëzimit, faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës, në respektim të parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe kohës së nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare.<sup>20</sup> Gjatë vitit 2020 ILD-ja arriti të shqyrtojë vetëm 65 ankesa nga ky fond.

Shqyrtimi i këtyre ankesave vijoi në vitin 2021 ku u shqyrtuan 427 ankesa.<sup>21</sup> Në vitin 2022, nga ILD u shqyrtuan nga ky fond **534** ankesa të tjera. Nga këto të dhëna rezulton se nga 2104 ankesa të mbartura që janë shqyrtuar deri më 31 dhjetor 2022 janë 1032 ankesa, duke mbetur ende një fond prej 1072 ankesash.

Duke pasur në konsideratë një mesatare prej 252 ditësh punë në vit rezulton se gjatë vitit 2021 ku janë shqyrtuar 427 ankesa, rezulton që të jenë shqyrtuar 1.7 ankesa në ditë. Ndërsa në vitin 2022 që janë shqyrtuar 534 ankesa, rezulton një mesatare shqyrtimi prej 2.1 ankesash në ditë.

### Ankesat e paraqitura pas krijimit të ILD-së

Mbas krijimit të ILD-së, që filloi të funksionojë më datë 1 shkurt 2020 e në vijim po japim të dhënat për shqyrtimin e ankimeve të reja të paraqitura në vitet 2020, 2021 dhe 2022 procedimet disiplinore, si edhe inspektimet tematike që janë realizuar në këtë periudhë.

<sup>20</sup> Raporti ILD-së për vitin 2021, fq.20

<sup>21</sup> Raporti ILD-së për vitin 2021, fq.12.

**Viti 2020**

Për sa i përket ankesave të paraqitura në vitin 2020, ato janë 950 ankesa të depozituara pas datës 1 shkurt, nga të cilat:

- 756 ankesa nga qytetarët;
- 185 ankesa nga institucione të tjera;
- 9 ankesa nga organizata të tjera.

Për shpërndarjen mujore të këtyre ankesave, u shfrytëzua si burim raportimi i ILD-së, por që u konstatua se kishte disa mospërputhje të të dhënave. Sipas të dhënave të publikuara nga vetë ILD-ja në raportin e tyre vjetor për vitin 2020 rezultoi se ankesa të drejtëpërdejtë në ILD nga institucionet janë 185 të tilla. Por nga ana e KLGJ janë dorëzuar në muajt qershor dhe korrik ankesat që ndodheshin të depozituara pranë këtij institucioni. Kjo shpjegon dhe numrin e lartë të ankesave për këto dy muaj në tabelën e mësipërme.

Nga bashkëpunimi me administratën e ILD-së rezultoi se është janë bërë disa gabime në tabelat e pasqyruara në raport, ku në muajin shkurt nga 8 ankesa janë pasqyruar 80, në muajin tetor numri 20 është bërë 21 dhe në muajin dhjetor numri 30 është bërë 3.

Nisur nga sa më sipër, shpërndaja mujore këtyre ankesave, mbas korrigjimit të të dhënave rezultoi që të jetë.

<b>Ankesa të paraqitura në vitin 2020</b>			
	<b>Qytetarët</b>	<b>Institucione</b>	<b>Organizata të tjera</b>
Janar			
Shkurt	152	8	
Mars	66	33	1
Prill	19	7	2
Maj	47	42	
Qershor	87	757	1
Korrik	72	1347	
Gusht	39	10	3
Shator	79	23	1
Tetor	87	20	
Nentor	49	12	1
Dhjetor	59	30	
<b>Total</b>	<b>756</b>	<b>2289</b>	<b>9</b>

Për sa i përket muajve qershor dhe korrik, në të dhënat e ILD-së janë pasqyruar vetëm të

dosjet e mbartura që janë përcjellë nga KLGJ-ja. Kjo nënkupton që për këto dy muaj nuk ka pasur asnjë ankesë nga institucionet publike. Kjo sjellje mund të shpjegohet që në muajin qershor u lehtësuan masat anti-COVID 19 nga ana e autoriteteve shtetërore dhe gradualisht filloi dhe puna e gjykatave.

Lidhur me shqyrtimin e tyre, janë miratuar në total 184 vendime pas shqyrtimit të ankesave dhe konkretisht:

- 42 vendime për verifikimin e ankesave, nga të cilat 13 janë arkivuar pas verifikimit dhe pjesa tjetër 29 janë në proces shqyrtimi;
- 142 vendime për arkivimin e ankesave; (të përfshira 13 vendimet e arkivimit pas verifikimit të përmendura më sipër);

Duke qenë se, në shumë raste ka paraqitje të më shumë se një ankesë për të njëjtën çështje ILD ka ndjekur praktikën e bashkimit të tyre. Për këtë arsye nga 142 vendime të arkivuara deri në dhjetor 2020, rezulton të jenë trajtuar 173 ankesa nga ILD.<sup>22</sup> Nga viti 2020 në vitin 2021 u mbartën 2.870 praktika.

Nga sa më sipër, duke pasur në konsideratë periudhën 1 shkurt deri më 31 dhjetor 2020, janë mesatarisht 230 ditë punë, rezulton se gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar 0.7 ankesa në ditë. Kjo përqindje e ulët lidhet me faktin e mungesës së burimeve njerëzore dhe materiale që karakterizuan ILD gjatë vitit 2020. Në këtë periudhë duhet të kemi në konsideratë dhe periudhën e karantimit të detyrueshëm të vendosur nga autoritetet shqiptare në kuadër të masave për luftimin e pandemisë COVID-19.

Për sa i përket procedimeve disiplinore, rezulton se ILD ka miratuar 8 vendime për fillimin e hetimit disiplinor përkatësisht për 2 (dy) prokurorë dhe 6 (gjashtë) gjyqtarë.

Nga këto hetime disiplinore të kryera, rezulton se:

- 6 prej tyre, (përkatësisht për 2 magjistratë prokurorë dhe 4 magjistratë gjyqtarë), janë hetime disiplinore të iniciuara kryesisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- 2 prej tyre përkatësisht për 2 magjistratë gjyqtarë, janë hetime disiplinore të iniciuara nga rastet e paraqitura nga institucione pranë ILD-së.

Për periudhën shkurt-dhjetor 2020 nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, janë formuluar 4 (katër) kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, 3(tre) pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 1(një) pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.<sup>23</sup>

Nga rastet e mësipërme 3 janë shqyrtuar nga këshillat respektive, ndërsa njëri nuk u përfundua gjatë vitit 2021. KLGJ-ja e cila shqyrtoi dy prej kërkesave i pranoi ato, ndërsa KLP-ja, vendosi rrëzimin e kërkesës.

Shohim me vend të ndalemi që vendimi i KLP-së u ankimua nga ILD-ja në Gjykatën Administrative të Apelit, ku u kërkua:

1. Shfuqizim/paligjshmëri akti administrativ të vendimit nr.269, datë 17.11.2020 të

<sup>22</sup> Raporti ILD-së për vitin 2020, fq.14

<sup>23</sup> Raporti ILD-së për vitin 2020, fq.14.

*Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të së cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor nr.251/31, datë 21.07.2020 ndaj prokurores E.K.*

*2. Zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë, pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe caktimin ndaj magjstrates E.K. të masës disiplinore "vërejtje publike", të parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja 'b' dhe neni 107 i ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "dh" e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar; ose: Detyrimin e KLP të vendosë ndaj magjstrates E.K. masën disiplinore "vërejtje publike", të parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja 'b' dhe neni 107 i ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja 'dh' e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar.*

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative Apelit, me vendimin nr. 86-2021-750, datë 13.12.2021, vendosi:

- 1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*
- 2. Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit nr. 269, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.*
- 3. Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*

Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, KLP-ja kishte kryer shkelje të rënda procedurale në rriçeljen e hetimit administrativ në marrjen e provave të reja dhe në mosnjoftimin e palëve për këto veprime procedurale. Bazuar në këto rrethana, Gjykata çmoi se nuk kishte më vend në shqyrtimin e kërkimeve të tjera të ILD-së.

Mënyra e veprimit të ILD-së në këtë rast, paraqet interes, pasi Kushtetuta, përcakton se janë këshillat që vendosin masat disiplinore dhe jo gjykatat. Mënyra e vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit në këtë rast paraqet edhe ajo interes, pasi kjo gjykatë vlerësoi vetëm shkeljet procedurale të KLP-së, por nuk pranoi të shqyrtojë mundësinë, nëse mundej apo jo të caktonte vetë një masë disiplinore.

Në ILD, janë referuar materiale edhe për verifikimin e rasteve kur mund të kishte shkelje disiplinore nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, që kishin të bënin me zhvillimin e seancës gjyqësore pa praninë e një pale,<sup>24</sup> prishja dhe pushimi i një vendimi të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e apelit,<sup>25</sup> gjykimi i një çështjeje në kushtet e konfliktit të interesit, gjykimi i një çështjeje nga gjyqtarja e apelit, kur më parë e kishte gjykuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë.<sup>26</sup>

Në të gjitha këto raste, ILD-ja vendosi arkivimin e çështjeve për shkak se kishte kaluar afati i parashkrimit, me përjashtim të një rasti, ku u vendos pezullimi i shqyrtimit të çështjes, pasi ankimi që kishte bërë Komisioneri Publik, ngrinte, ndër të tjera, pretendime për këto shkelje. Rezulton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ka marrë në shqyrtim këto shkelje dhe ka vendosur se

<sup>24</sup> Vendim nr. 257, datë 12.6.2020 i KPK-së.

<sup>25</sup> Vendim nr.242, datë 28.2.2020 i KPK-së.

<sup>26</sup> Vendim nr.273, datë 10.7.2020 i KPK-së.

një pjesë e tyre nuk qëndronin dhe një pjesë tjetër që nuk ishin të tilla që të sillnin përgjegjësi disiplinore.<sup>27</sup> Duke qenë se në përfundim subjekti u shkarkua për shkaqe të tjera, në thelb kjo çështje mbeti pa objekt.

Bazuar në pikën 4 të nenit 194 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe në planin vjetor të inspektimeve, kryen dhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë. Fillimisht nga ana e ILD u miratua Vendimi nr. 1 datë 11.02.2020, "Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirim me Kusht". Por për shkak të mospërgjigjes në kohë nga institucionet përkatëse dhe personelit të kufizuar të ILD, ky inspektim tematik vijoi dhe në vitin 2021. Megjithatë deri në momentin e hartimit të këtij raporti, ky inspektim tematik është ende në proces përfundimi.

## Viti 2021

Sipas të dhënave të publikuara nga vetë ILD, gjatë këtij viti janë depozituar 1257 ankesa të reja, të cilat të ndara këto sipas subjekteve ankuuese rezulton se janë:

- 1210 ankesa të depozituara nga persona fizikë ose individë;
- 28 ankesa të depozituara nga organe publike;
- 12 ankesa të depozituara nga organizata të shoqërisë civile;
- 7 ankesa të depozituara nga media.<sup>28</sup>

Shpërndarja mujore e këtyre ankesave është si më poshtë:

<b>Ankesa të paraqitura në vitin 2021</b>			
	<b>Qytetarët</b>	<b>Institucione</b>	<b>Organizata të tjera</b>
<b>Janar</b>	103	7	1
<b>Shkurt</b>	80	8	-
<b>Mars</b>	83	30	2
<b>Prill</b>	110	15	-
<b>Maj</b>	109	9	
<b>Qershor</b>	134	6	
<b>Korrik</b>	101	21	
<b>Gusht</b>			
<b>Shator</b>	65	5	
<b>Tetor</b>	89	8	2
<b>Nentor</b>	81	17	
<b>Dhjetor</b>	121	7	
<b>Total</b>	<b>1076</b>	<b>133</b>	<b>5</b>

<sup>27</sup> Vendim nr. 35/2021 (JR) datë 23.11.2021 i KPA-së.

<sup>28</sup> Raporti ILD-së për vitin 2021, fq.12



Të dhënat e mësipërme mbi baza mujore janë nxjerrë nga buletinet mujore të ILD-së. Siç rezultojnë përsëri ka një mospërputhje të të dhënave në raport me ato të raportuara në raportin vjetor të ILD-së. Pavarësisht kësaj mospërputhjeje, jemi të mendimit që raporti vjetor duhet të tregojë të dhënat e konsoliduara, duke eliminuar dhe gabimet që mund të jenë pasqyruar në buletinet mujore.

Shifrës së mësipërme i duhet shtuar ajo e praktikave të mbartura duke shkuar në total 4127 ankesa që mbeteshin për t'u shqyrtuar. Nga këto ankesa, ILD ka publikuar se ka shqyrtuar 1719 ankesa, nga të cilat 427 ankesa, sipas ILD janë nga fondi i mbartur nga ish-KLD. Bazuar tek shifra 1292 dhe duke llogaritur një mesatare vjetore prej 252 ditësh punë, rezultojnë se nga ILD janë shqyrtuar mesatarisht 5.1 ankesa në ditë. Nëse do të përfshijmë dhe shqyrtimin e ankesave të mbartura, pra një total prej 1719 ankesash, rezultojnë se nga ILD janë shqyrtuar mesatarisht 6.8 ankesa në ditë.

Rezultati i shqyrtimit të ankesave është:

- 990 vendime për arkivimin e 1433 ankesave; prej të cilave 785 vendime janë marrë pas shqyrtimit fillestar, dhe 205 vendime arkivimi janë marrë pasi në përfundim të verifikimit të ankesës, është konstatuar se nuk ka fakte të mjaftueshme për të filluar fillimin.
- 197 vendime për verifikimin e 270 ankesave, të cilat do të vijonë për vitin 2022;
- 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor për 31 subjekte të hetimit disiplinor;
- 17 kërkesa për procedim disiplinor pranë Këshillave.

Në total në fund të vitit 2021, u mbartën për në vitin 2022, 2678 ankesa, ku përfshihen dhe ato të fondit të mbartur.

Kundër vendimeve të arkivimit janë depozituar pranë këshillave, sa më poshtë:

- 80 ankimime ndaj 785 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- 4 ankimime ndaj 205 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;

Asnjë prej ankimeve nuk është rikthyer për rishqyrtim nga ana e Këshillave.<sup>29</sup> Sa i përket procedimeve disiplinore, për vitin 2021, 5 raste të iniciuara nga viti 2021 janë përfunduar dhe 4 prej tyre vazhdojnë të jenë të pezulluara për shkak të procesit të rivlerësimit të magjistratit për të cilin është paraqitur kërkesë për procedim pranë Këshillit.<sup>30</sup>

ILD ka miratuar 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor. Nga këto për 17 magjistratë është paraqitur kërkesë për procedim disiplinor pranë këshillave ndërsa për 14 subjektet e tjerë të hetimit disiplinor rezultatet e hetimit janë sa vijon:

- *Për 1 magjistratë është pezulluar hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;*
- *Për 4 magjistratë është mbyllur hetimi disiplinor për shkak të mbarimit të statusit të*

<sup>29</sup> Raporti i ILD-së për vitin 2021, fq.14-15;

<sup>30</sup> Vendimet nr.463, datë 11.10.2021, nr.559, datë 1.12.2021, nr.494, datë 25.10.2021 të KLGJ-së.

*magjistratit, vlerësimet të fakteve, rrethanave të hetuara dhe provave të marra, si të pamjaftueshme për të provuar shkeljet e pretenduara;*

- *Për 9 subjekte të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në faza të ndryshme sipas kërkesave të ligjit për zhvillimin e tyre.*

Nga 17 kërkesat e paraqitura, rezulton se 11 prej tyre u paraqitën KLGJ-së, ndërsa 6 prej tyre KLP-së. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve Këshilli i Lartë i Gjyqësor:

- *nga 6 raste ku është kërkuar masa "Shkarkim nga detyra", KLGJ ka pranuar kërkesat për 2 magjistratë, ka përfunduar procedurën disiplinore për shkak të mbarimit të statusit për 2 raste dhe për 1 rast procedimi disiplinor është në proces, ndërsa për rastin tjetër procedimi disiplinor është pezulluar.*
- *nga 5 raste ku është kërkuar masa "Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit",*
- *ka pranuar 2 kërkesa duke vendosur për një masë të ndryshme disiplinore,*
- *në 3 raste ka vendosur pezullim e procedimit disiplinor.*

Për 6 kërkesat për procedim disiplinor të paraqitura në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar këto masa disiplinore:

- *Shkarkim nga detyra" - 3 raste;*
- *"Vërejtje publike" - 3 raste.*

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

- *nga 3 raste "Shkarkim nga detyra", ka pranuar 1 kërkesë, ndërsa 2 rastet e tjera procedimi disiplinor është në proces;*
- *nga 3 raste "Vërejtje publike", ka pranuar 1 kërkesë, ndërsa për 2 raste procedimi disiplinor është në proces.<sup>31</sup>*

Gjatë shqyrtimit të të dhënave nga KPA, rezulton se nga tre vendime të ankmuara, në të gjitha rastet ankimet nuk janë pranuar (vendimet 1/2022 (JD), datë 30.05.2022, nr. 2/2022 (JD), datë 31.05.2022 dhe nr. 3/2022 (JD), datë 07.12.2022).

Edhe gjatë vitit 2021, pati referime nga KPK, për shkaqe si ndërhyrja në procesverbalin gjyqësor ditën e inspektimit, zvarritje e gjykimit, dhënia e një mase sigurimi personal jo në përputhje me nevojat e sigurimit, vonesa në zbardhjen e vendimeve,<sup>32</sup> zvarritje të procesit gjyqësor, zhvillimi i procesit ligjor të kundërligjshëm, shkelje flagrante të ligjit, mosarsyetim vendimi, shkelje procedurale, vendimmarrje të kundërligjshme,<sup>33</sup> dhënia e vendimeve të padrejta dhe abuzive.<sup>34</sup> Edhe në këto raste është vendosur arkivimi i tyre pasi në të gjitha rastet kishte

<sup>31</sup> Raporti i ILD-së, për vitin 2021, fq.19.

<sup>32</sup> Vendim nr.355, datë 16.3.2021 i KPK-së.

<sup>33</sup> Vendim nr. 522, datë 1.4.2022 i KPK-së

<sup>34</sup> Vendim nr. 394, datë 7.6. 2021 i KPK-së

kaluar afati i parashkrimit.

Sa i përket inspektimet tematike ILD përveç inspektimit tematik të nisur në 2020 filloi dhe dy inspektime të tjera në vitin 2021 dhe konkretisht :

- 1 *Vendim nr. 37, datë 01.06.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: "Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i ndryshuar.*
- 2 *Vendim nr. 47, datë 15.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: "Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal" për veprën penale "Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit".*

Bazuar në të dhënat e mbledhura për inspektimin tematik për "lirimin me kusht", janë paraqitur 2 kërkesat për procedim disiplinor në vitin 2020 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021.

Sa i përket inspektimit tematik me objekt: "Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal" për veprën penale "Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", grupi i punës mbasi ka konstatuar probleme në mos mbajtjen siç duhet të procesverbaleve të arrestimit dhe ndalimit në flagrancë, mosvlerësimin siç duhet të kriterëve ligjore për kërkimin e masave të sigurimit personal, mos raportimin e rasteve kur prokurorët e çështjeve kanë vendosur që të mos bëjnë ankim ndaj vendimeve të gjykatave etj, ka dhënë rekomandime, për prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për korrigjimin e këtyre të metave, lëshimin e udhëzimeve detyruese nga PP, realizimin e trajnimeve, si edhe shtrirjen e inspektimeve për këtë tematikë dhe tek gjykatat e rretheve.<sup>35</sup>

Në lidhje me inspektimin tematik me objekt: "Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i ndryshuar, ka rezultuar se ka pasur angazhim nga prokuroritë e rretheve dhe të apeleve për zbatimin e udhëzimit nr.12/2020 të PP-së, por këto kanë qenë të kufizuara. Shpesh herë mungonin udhëzimet e përgjithshme të drejtuesve të prokurorive dhe në ato raste kur udhëzimet janë nxjerrë, ato nuk pasqyrojnë afatin dhe mënyrën e ankimit të tij.

<sup>35</sup> Raporti i inspektimit mbi "Respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal" për veprën penale "Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit", marrë nga adresa: <https://ild.al/sq/2022/11/11/raport-i-inspektimit-mbi-respektimin-e-kushteve-dhe-kriterëve-per-caktimin-e-masave-te-sigurimit-personal-per-vepren-penale-te-mbajtjes-pa-leje-dhe-prodhimit-te-armeve-armeve-shperthyes-dhe-munici/>

Por asnjë prokuror nuk e ka ankimuar ndonjë udhëzim të përgjithshëm të drejtuesit të prokurorisë në KLP, kurse në pak raste udhëzimet e përgjithshme të drejtuesve të prokurorive janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.12/2020 të PP-së.

Raporti nxjerr problematika në lidhje me udhëzimet jo të detyrueshme të drejtuesve të prokurorive, unifikimin e termave, moskomunikimi me shkrim për çështjet midis prokurorit të çështjes dhe drejtuesit të prokurorisë si dhe mosraportimi në PP. Nga të dhënat e marra, për periudhën e inspektimit, nuk rezulton ndonjë rast që nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë si prokurori më i lartë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave, të jetë kërkuar fillimi i verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit lidhur me zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme. Po kështu, nuk ka pasur të dhëna lidhur me kërkesa të tilla edhe nga prokurorët përkundrejt Drejtuesit të Prokurorisë, zëvendësdrejtuesit sipas parashikimeve të të njëjtit udhëzim.

Mbi këtë bazë ka rekomandime për Prokurorinë e Përgjithshme, prokuroritë e apeleve dhe të rretheve që:

- *të përditësojnë udhëzimet e tyre të përgjithshme edhe në raport me udhëzimet e tjera të Prokurorit të Përgjithshëm,*
- *rishikimi i udhëzimeve që ka nxjerrë drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Shkodër, Korçë, si edhe drejtuesit e Prokurorive të Apeleve, Korçë, Durrës,*
- *riorganizimi i zyrave të prokurorive të rretheve, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së tyre edhe në drejtim të nxjerrjes së udhëzimeve nga ana drejtuesve të prokurorive, nxjerrjen e udhëzimeve jodetyruese për çështjet,*
- *raportimi pranë PP-së për gjendjen e kriminalitetit, drejtuesit e prokurorive të apelit duhet të vlerësojnë kërkesat e udhëzimit nr.12/2020 për marrjen e informacionit, unifikimin e mënyrës së të informuarit të drejtuesit të prokurorive,*
- *PP të përdorë kompetencat e saj për udhëzime jodetyruese, të sqarojë disa pika të udhëzimit nr.12/2020, të rritet bashkëpunimi midis prokurorive,*
- *për Shkollën e Magjistraturës, rekomandohet marrja e masave për rritjen profesionale, si dhe vijimin e trajnimeve të prokurorëve me tema në kuadrin e ri ligjor të funksionimit të prokurorisë, etj.<sup>36</sup>*

## Viti 2022

Për vitin 2022, ILD ende nuk ka publikuar raportin e tij, për këtë arsye për nxjerrjen e të dhënave jemi bazuar në buletinet mujore që ka nxjerrë vetë ILD në periudhën janar-dhjetor 2022, si edhe duke komunikuar me vetë administratën e ILD-së.

<sup>36</sup> Raporti i inspektimit tematik "Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", marrë nga adresa: <https://ild.al/sq/2023/01/17/raport-per-kryerjen-e-inspektimit-tematik-te-prokurorive-te-juridiksionit-te-pergjithshem-me-objekt-mbi-marrjen-e-masave-administrative-dhe-procedurale-ne-kuader-te-zbatimit-te-udhezimit-te-per/>

Nga këto buletine rezulton se për vitin 2022 janë depozituar 789 ankesa të reja, të ndara këto sipas subjekteve ankuese rezulton:

- 756 ankesa të depozituara nga persona fizikë ose individë;
- 32 ankesa të depozituara nga organe publike;
- 1 ankesa të depozituara nga organizata të shoqërisë civile.<sup>37</sup>

Nga ana e ILD-së rezulton që të jenë shqyrtuar dhe 534 ankesa nga ato të mbarturat në vite përpara krijimit të këtij institucioni. Rezulton se nga ana e ILD **janë shqyrtuar në total 1715 ankesa**, një pjesë të cilave janë grupuar si më poshtë:

- **1502** ankesa janë depozituar nga persona fizikë;
- **212** ankesa janë depozituar nga persona juridikë, përkatësisht:
- **1** ankesë anonime, pasi nuk evidentohet emri i ankuesit.

Për 1715 ankesave të shqyrtuara, janë miratuar **1234** vendime sipas kategorive të mëposhtme:

- **862** vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të **1220** ankesave;
- **344** vendime për arkivimin pas verifikimit të **425** ankesave;
- **28** vendime për hetim disiplinor pas shqyrtimit të **70** ankesave për 41 subjekte të hetimit disiplinor.

Pas përfundimit të hetimeve disiplinore rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

- për 6 magjistratë (3 gjyqtarë dhe 3 prokurorë) janë paraqitur pranë këshillave respektive kërkesat për procedim;
- për 1 magjistrat (1 gjyqtar) është pezulluar hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për procesin e rivlerësimit;
- për 22 magjistratë (20 gjyqtarë dhe 2 prokurorë) është mbyllur hetimi disiplinor;
- për 14 magjistratë (13 gjyqtarë dhe 1 prokuror) të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në proces.

Për 8 subjektet të hetimit disiplinor, hetimi ndaj të cilëve ka filluar në vitin 2021, hetimet kanë vijuar edhe gjatë vitit 2022, konkretisht:

- për 2 magjistratë është pezulluar hetimi;
- për 3 magjistratë dhe 3 subjekte të tjerë, është mbyllur hetimit.

Nga ana e KPK-së ka pasur referime çështjes edhe në këtë vit, ku një rast ka të bëjë me mbajtjen e një qëndrimi që nuk ka pasur bashkëpunim nga të pandehur në kryerjen e veprës penale të kultivimit të narkotikëve, vendim që është ndryshuar nga gjykata e apelit.<sup>38</sup>

Duke llogaritur përsëri një mesatare vjetore prej 252 ditësh punë, si edhe duke pasur në konsideratë numrin e rasteve të shqyrtuara, prej 1715 ankesash, rezulton se nga ILD janë shqyrtuar mesatarisht 6.8 ankesa në ditë, në raport të njëjtë me vitin 2021.

<sup>37</sup> Të dhëna të nxjerra nga Buletinet nr.12-22, muajt janar-dhjetor 2022.

<sup>38</sup> Vendimi nr.522, datë 1.4.2022 i KPK-së.

Sa i përket procedimeve disiplinore për vitin 2022 nga të dhënat e aksesuara rezultojnë se KLGJ, ka pezulluar procedimin disiplinor ndaj një magjistrati deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 541, datë 15.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.<sup>39</sup> Kurse në një rast tjetër, KLGJ-ja ka vendosur masën disiplinore të pezullimit nga detyra, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë 3 (tre) mujore.<sup>40</sup>

Sa i përket KLP-së nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të internetit nuk gjenden të dhëna për vendimmarrje për procedime disiplinore në vitin 2022. Në këtë rast rezultojnë se ka marrë një vendim pezullimi të procedimit disiplinor, për shkak se subjekti procedues ishte shkarkuar më parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.<sup>41</sup> Edhe KLP-ja në këtë rast, do të presë vendimmarrjen e KPA-së, përpara së të procedojë vetë në lidhje me këtë çështje.

---

<sup>39</sup> Vendimi nr. 436, datë 25.10.2022 i KLGJ-së

<sup>40</sup> Vendimi nr.267, datë 19.7.2022 i KLGJ-së.

<sup>41</sup> Vendimi nr.508 datë 10.2.2022 i KPK-së.

## Bibliografia

### Legjislacion

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”
- Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

### Vendime

- Vendim nr.3 datë 1.3.2019 i KED
- Vendim nr. 53 datë 24.7.2019 i KED
- Vendim nr. 77 datë 24.7.2019 i KED
- Vendim nr. 101 datë 30.7.2019 i KED
- Vendim nr. 107, datë 2.8.2019 i KED
- Vendimi nr. 2 datë 20.1.2020 i Kuvendit të Shqipërisë.
- Vendimi nr. 69, datë 07.02.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirim me Kusht” të ILD-së.
- Vendimi nr.242, datë 28.2.2020 i KPK-së.
- Vendimi nr.257, datë 12.6.2020 i KPK-së.
- Vendimi nr.273, datë 10.7.2020 i KPK-së.
- Vendimi nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- Vendim nr.37, datë 05.02.2020 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendim nr.18, datë 27.01.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendim nr.19, datë 27.01.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendim nr.20, datë 27.01.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendim nr.21, datë 27.01.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendim nr.355, datë 16.3.2021 i KPK-së.
- Vendim nr.394, datë 7.6.2021 i KPK-së.
- Vendim nr.35/2021 (JR) datë 23.11.2021 i KPA-së.

- Vendim nr. 86-2021-750, datë 13.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit.
- Vendim nr.508, datë 10.2.2022 i KPK-së.
- Vendim nr.522, datë 1.4.2022 i KPK-së
- Vendim nr.1/2022 (JD), datë 30.05.2022 i KPA-së.
- Vendim nr.2/2022 (JD), datë 31.05.2022 i KPA-së.
- Vendim nr.3/2022 (JD), datë 07.12.2022 i KPA-së.

### Raporte

- Raport mbi gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018, publikuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor 2019
- Raporti i inspektimit tematik “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
- Raporti i inspektimit mbi “Respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.
- Raporti për vitin 2020 i ILD-së.
- Raporti për vitin 2021 i ILD-së.

### Buletine të ILD-së

- Buletini nr.1, janar 2021.
- Buletini nr.2, shkurt 2021.
- Buletini nr.3, mars 2021.
- Buletini nr.4, prill 2021.
- Buletini nr.5, maj 2021.
- Buletini nr.6, qershor 2021.
- Buletini nr.7, korrik 2021.

- *Buletini nr.8, shtator 2021*
- *Buletini nr.9, tetor 2021*
- *Buletini nr.10, nentor 2021*
- *Buletini nr.11, dhjetor 2021*
- *Buletini nr.12, janar 2022.*
- *Buletini nr.13, shkurt 2022.*
- *Buletini nr.14, mars 2022.*
- *Buletini nr.15, prill 2022.*
- *Buletini nr.16, maj 2022.*
- *Buletini nr.17, qershor 2022.*
- *Buletini nr.18, korrik 2022.*
- *Buletini nr.19, shtator 2022.*
- *Buletini nr.20, tetor 2022.*
- *Buletini nr.21, nentor 2022.*
- *Buletini nr.22, dhjetor 2022.*
- <http://parlament.al/Files/Akte/20200124111759vendim%20nr%20%202%20dt%20%2020%201%202020.pdf>
- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_qenci\\_ismaili\\_2058.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_qenci_ismaili_2058.pdf)
- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_suzana\\_frasheri\\_2046.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_suzana_frasheri_2046.pdf)
- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_lefteri\\_lleshi\\_luzi\\_2041.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_lefteri_lleshi_luzi_2041.pdf)
- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje\\_dore\\_elira\\_kokona\\_2113.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/heqje_dore_elira_kokona_2113.pdf)
- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/LIST\\_AEKANDIDAT\\_VE\\_T\\_NDALUAR\\_NGA\\_KANDIDIMET\\_P\\_R\\_VENDIN\\_VAKANT\\_P\\_R\\_INSPEKTOR\\_T\\_LART\\_T\\_DREJT\\_SIS\\_6064\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/LIST_AEKANDIDAT_VE_T_NDALUAR_NGA_KANDIDIMET_P_R_VENDIN_VAKANT_P_R_INSPEKTOR_T_LART_T_DREJT_SIS_6064_1.php)
- <https://ild.al/sq/2022/11/11/raport-i-inspektimit-mbi-respektimin-e-kushteve-dhe-kritereve-per-caktimin-e-masave-te-sigurimit-personal-per-vepren-penale-te-mbajtjes-pa-leje-dhe-prodhimit-te-armeve-armeve-shperthyese-dhe-munici/>

#### **Faqe interneti**

- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kandidate\\_te\\_terhequr\\_perpara\\_procedures\\_se\\_verifikimit\\_5916\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kandidate_te_terhequr_perpara_procedures_se_verifikimit_5916_1.php)



